

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

*“Blerje materiale inerte”*

#### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**14211000 – 3**

**14212430 – 3**

**14212310 – 6**

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

6 034 132(gjashtë milion e e tridhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë e dy lekë) lekë pa tvsh.

Bazuar në nenin 76 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, në zbatim të urdhërit të titullarit, për ngritjen e komisionit për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës sipas specifikimeve teknike për këtë procedurë prokurimi, komisioni bazuar në VKM 285 datë 19.05.2021 neni 76, pika a) manualit të cmimeve të ndertimit 2023 nga portali e Albania) ka bërë përlogaritjen e vlerës limit të kontrates.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta për kualifikim për procedurën, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

*Në zbatim të nenit 83 të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020) është 2% e fondit limit.*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: " Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata ".*

*Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetare, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme."*

*Sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës Procedurë e hapur të thjeshtuar, edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).*

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

**2.2.3** Vërtetimi të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2025 në të gjithë adresat e ushtrimit të aktivitetit sipas ekstraktit të QKB-së.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Kapaciteti Teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet min 16 ton	3 copë	pronësi/përdorim/qira

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve të sipërpërmendura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë;

a) **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:**

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. Certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Policë sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti të shoqërohet me fotografi të dukshme

**Për mjetet me përdorim/qira**

1. Për mjetet e marra me përdorim/qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e huapërdorjes/qirasë (me vlefshmeri sa kohëzgjatja e MK).
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme)

4. Policë sigurimi (e vlefshme)
5. Mjeti të shoqërohet me fotografi të dukshme.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në zbatim të nenit 26 pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** *Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), është përcaktuar ky kriter, me anë të të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor se disponojnë mjetet e nevojshme të transportit dhe se do të kryejnë levrimin e mallrave objekt prokurimi. Vendosja e këtij kriteri synon të sigurojë që operatori ekonomik të garantojë shërbimin e transportit në kohë dhe në përputhje me afatet e kontratës..*

*Kërkesa për të pasur në dispozicion minimumi tre mjete transporti është përcaktuar në mënyrë proporcionale me sasinë e mallrave të kërkuar dhe me vendndodhjen e Autoritetit Kontraktor, ku ky mall do të përdoret. Ky kusht garanton sigurinë, vijueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit të transportit, duke ulur rrezikun e vonësive ose ndërprerjeve në procesin e furnizimit.*

**2.3.3** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar 3 (tre) drejtues mjetesh për mjetet e kerkuara.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punojësve të sipërpërmendur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vleresimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

- kontratë pune të vlefshme;
- dëshminë e drejtimit të automjetit të vlefshme;

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të*

*mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se „5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“.*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, për dorëzimin e mallit në kohë dhe pa vonesa.*

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë nëpërmjet së cilës merr përsipër levrimin e mallit objekt prokurimi në destinacionin e kërkuar nga AK.

**Argumentimi:** *Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), është përcaktuar ky kriter, me anë të të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor se marrin përsipër levrimin e objekt prokurimi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.*

*Deklarata i shërben AK si një instrument sigurie që minimizon rrezikun e mos levrimit të mallit sipas kërkesave të AK, rrit përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik, krijon bazë për monitorim dhe zbatim korrekt të kontratës.*

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

AK rezervon mundësinë e verifikimit të certifikatave pranë DPA në Ministrinë e Financave.

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat objekt prokurimi plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. E njëjta dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike lidhen me kualifikimet e kandidatit apo ofertuesit. Gjithashtu, ky kriter mbështetet në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285,*

*datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve paraqitjen e certifikatave të tilla vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është vendosur për të garantuar njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë dhe për të vlerësuar aftësinë e tyre teknike dhe profesionale në drejtim të furnizimit me artikuj cilësorë, të prodhuar ose të hedhur në treg sipas standardeve ndërkombëtare. Certifikata e kërkuar ka lidhje dhe është proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **Specifikime Teknike**

Specifikimi i Materialeve:

1. **Granil i thyer guri:** Materiali i këtij granili është parashikuar të gjëndet në natyrë, duke bërë përzgjedhjen e tij dhe kalimin në sistem me dimensione deri 0 – 5 mm, duke respektuar kërkesat e mëposhtme:

Para përdorimit të granilit natyror është e domosdoshme të kryhen provat e granulometrisë dhe të ngjeshjes. Granulometria e granilit duhet të jetë e rjedhshme me përmbajtje të të gjitha dimensioneve të kokrrizave 0 -5 mm. Për të pasur një ngjeshje maksimale prej 92% është e nevojshme që kurba e granulometrisë të futet në fuzën e grafikut sipas standartit shtetëror STASH 539-82. Granili do të jetë i paster, i forte, i qendrueshëm, kubik dhe të formuar mirë, pa lende të buta apo të thermueshme, ose copeza të holla të stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substanca të tjera të demshme.

2. **Rërë e larë lavatrice** me përmasa 0-5 mm.

E gjitha kjo duhet të jete e pastruar shume mire, pa masa të mpiksura, cifla të buta e të vecanta, vajra distilimi, alkale, lende organike, argjile dhe sasi të substancave të tjera demtuese.

3. **Cakell makinerie** dhe **Stabilizant** fraksion 5-10 mm:

Materiali i këtij cakelli dhe stabilizanti është parashikuar të gjëndet në natyrë, duke bërë përzgjedhjen e tij dhe kalimin në site me dimensione deri në 5-10 mm duke respektuar kërkesat e mëposhtme. Para përdorimit të cakellit të makinerisë dhe stabilizantit është e domosdoshme të kryhen provat e granulometrisë dhe të ngjeshjes. Granulometria e granilit duhet të jetë e rjedhshme me përmbajtje të të gjitha dimensioneve të kokrrizave 5-10 mm. Për të patur një ngjeshje maksimale prej 92% (proctor i modifikuar) është e nevojshme që kurba e granulometrisë të futet në fazën e grafikut sipas standartit shtetëror STASH539-82. Materiali guror duhet të ketë fortesinë 600-800 kg/cm<sup>2</sup>, marke termimi nga prova LOS ANXHELOS LA=16-30% pa përmbajtje elemente bimore apo argjile.

**Argumentimi i specifikimeve teknike:** Specifikimet teknike të përcaktuara për materialet granulare (granil i thyer guri, rërë e larë dhe cakëll/stabilizant) janë hartuar me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë, jetëgjatësisë dhe performancës së strukturave rrugore.

Granil i thyer guri (0–5 mm)

Përdorimi i granilit natyror të përzgjedhur dhe të përpunuar në fraksion 0–5 mm është thelbësor për arritjen e një shtrese homogjene dhe me densitet të lartë. Kërkesa për kryerjen e provave të granulometrisë dhe ngjeshjes para përdorimit siguron shpërndarje të kontrolluar të madhësisë së grimcave, që ndikon drejtpërdrejt në kompaktimin optimal, reduktim të boshllëqeve ndërmjet grimcave dhe rritje të rezistencës mekanike, arritjen e një shkalle ngjeshjeje  $\geq 92\%$ , që është standard për shtresa të qëndrueshme dhe rezistente ndaj deformimeve.

Përfshirja e kurbës granulometrike brenda “fuzës” së lejuar sipas standardeve siguron një përzierje të balancuar, duke shmangur segregimin dhe uljen e qëndrueshmërisë strukturore.

Kërkesat sipas STASH 539-82

Referimi ndaj standardit STASH 539-82 garanton cilësinë fiziko-mekanike të materialit, duke kërkuar që granili të jetë I pastër dhe pa përmbajtje të dëmshme (argjila, lëndë organike, kripëra, etj.), me qëndrueshmëri të lartë ndaj konsumit dhe faktorëve atmosferikë, formë të përshtatshme (jo kokrra të holla ose të sheshta që ulin ndërthurjen mekanike).

Këto kërkesa janë thelbësore për të shmangur degradimin e shtresës rrugore dhe për të garantuar jetëgjatësi në kushte reale shfrytëzimi.

Rërë e larë lavatrice (0–5 mm)

Rëra e larë me fraksion 0–5 mm përdoret për të përmirësuar punueshmërinë dhe për të mbushur boshllëqet ndërmjet agregateve më të mëdha. Kërkesa që materiali të jetë i larë dhe pa përmbajtje të dëmshme justifikohet sepse eliminon praninë e argjilës dhe pluhurave që ndikojnë negativisht në lidhjen dhe kompaktimin, rrit qëndrueshmërinë dhe uniformitetin e shtresës, përmirëson drenazhimin dhe ul rrezikun e degradimit nga uji.

Cakëll makinerie dhe stabilizant (5–10 mm)

Përdorimi i cakëllit dhe stabilizantit me fraksion 5–10 mm është i domosdoshëm për krijimin e skeletit mbajtës të shtresës. Kërkesat për kryerjen e provave të granulometrisë dhe ngjeshjes, arritjen e densitetit optimal ( $\geq 92\%$  sipas Proctor-it të modifikuar), përputhjen e kurbës granulometrike me standardet janë të nevojshme për të siguruar një strukturë me kapacitet mbajtës të lartë dhe rezistencë ndaj deformimeve plastike.

Kërkesa për fortësi ( $600\text{--}800\text{ kg/cm}^2$ ) dhe rezistencë ndaj konsumit (Los Angeles 16–30%) garanton që materiali të përballojë ngarkesat dinamike dhe trafikun pa u degraduar.

Specifikimet e vendosura nuk janë kufizuese, por funksionale dhe të domosdoshme për të garantuar Cilësi të lartë të materialeve, qëndrueshmëri strukturore afatgjatë, siguri dhe performancë në përdorim.

Në këtë kuadër, kërkesat janë në përpjesëtim të drejtë me natyrën e projektit dhe synojnë të sigurojnë zbatim korrekt teknik dhe jetëgjatësi të investimit publik.

Specifikimet teknike jane hartuar nga grupi i punes ne perberje te se cilit eshte pencialisti i fushës anetra i njesise se prokurimit.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.**

## **NJESIA E PROKURIMIT**

**Senada Ndini**

**Ing. Eduard Hila**

**Teuta Dano**